



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KOMISIONERI PËR MBROJTJEN NGA DISKRIMINIMI

Nr. 361 Prot.

Tiranë, më 16.02.2026

V E N D I M

Nr. 30, datë 16 .02. 2026

Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi¹, bazuar në nenin 32, pika 1, gërma “a”, të ligjit nr. 10221, datë 04.02.2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”², të ndryshuar, mori në shqyrtim ankesën nr. 212 Regj, datë 29.09.2025, paraqitur nga pala ankuese znj. E.U kundër Drejtorisë Rajonale të Arsimit Parauniversitar Durrës³, me pretendimin për diskriminim në kuadër të “çdo shkak tjetër”. Në përfundim të shqyrtimit të ankesës, Komisioneri,

K O N S T A T O I:

I. Parashtrimi i fakteve sipas subjektit ankues.

Në ankesën e depozituar pranë Komisionerit, ankuesja znj. E.U parashtron:

Ankesa ime i referohet DRAP Durrës mbi vendimin urdhër-pezellimi të nxjerrë nga ana e tyre. Pretendimi im është se unë nuk jam e dënuar, prezumohem e pafajshme sa kohë që Gjykata nuk ka një vendim të formës së prerë. Ankimi im buron në disa shkaqe:

Shkaku është se jam e papunë, pa asnjë të ardhur, në pritje të odisesë që zgjat në hierarkinë e saj, për të marrë drejtësinë e munguar, pasi arsyetimi i DRAP Durrës në urdhëresën e tij, pretendon që mua nuk më lejohet të punoj në arsim, sepse paskam një vendim që buron nga vendimi i Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Durrës.

DRAP Durrës në vendim marrjen e pezullimit thekson: “deri në përfundimin e procesit gjyqësor, masat e pezullimit mbeten në fuqi dhe unë nuk mund të kthehem në detyrë në zbatim të nenit 55, të

¹ Në vijim do t'i referohemi me shkurtesën Komisioneri.

² Në vijim do t'i referohemi me shkurtesën LMD.

³ Në vijim do t'i referohemi me shkurtesën DRAP Durrës.

ligjit 69/2012 “Për sistemin arsimor parauniversitar në Republikën e Shqipërisë” i ndryshuar “Emërimi, ulja në detyrë, pezullimi e shkarkimi i drejtuesit të IA-së, pika 5/b: Titullari i institucionit rajonal arsimor përkatës, përgjegjës për arsimin parauniversitar, ul në detyrë, pezullon, shkarkon apo përfundon marrëdhëniet e punës për drejtuesin e IA-së në rast se: për drejtorin e IAP pezullohet marrëdhënia e punës dhe efektet financiare deri në shpalljen e vendimit të formës së prerë ndaj tij gjykata kompetente në rastet kur: Gjykata ka vendosur masat e sigurimit personal ndaj tij ose kur është në proces hetimi për kryerjen e një veprë penale, sipas nenit 60/1 të këtij ligji. DRAP Durrës për të dy nenet bie ndesh me ligjin, pasi ndaj meje nuk ka një vendim të formës së prerë. Nisur nga këto nene, ndaj meje nuk ka asnjë masë sigurie apo proces hetimi siç pretendon DRAP Durrës.

DRAP Durrës është në shkelje dhe në shpërdorim detyre, pasi ka tejkaluar kompetencat e veta, duke dalë mbi gjykatën dhe më keq akoma kryen interpretime të vendimeve gjyqësore.

Konstistuiimi i formulimit mbi urdhër pezullimin ndaj meje është tendencioz, i qëllimtë, denigrues dhe arrin deri në shkallën e diskriminimit sa që fut tmerrin kur mendon. VKM nr.23, datë 21.11.2023 në pikën 1 të saj, po ashtu sikurse neni 60 i ligjit, parashikon se : “Punonjësi arsimor, si dhe çdo punonjës tjetër i SAPU, që punon me fëmijët, nuk mund të punësohet dhe kur është i puënsuar përfundon marrëdhënien e tij të punës, në rast se është dënuar me vendim penal të formës së prerë për kryerjen e një veprë penale që për shkak të natyrës së veprës penale së kryer, diskrediton pozitën dhe figurën e punonjësit arsimor ose dëmton rëndë besimin e publikut”. E pra unë as kam vjedhur, as kam vrarë, as kam abuzuar me ndonjë gjë në jetën time, kam punuar, punoj e do vazhdoj të punoj me ndershmeri, se kështu kam lindur, kështu jam rritur e edukuar, në dejet e mia buron edukimi shembullor i etërve të mi dhe i mësuesve të mi të vyer.

DRAP Durrës duke qenë se është institucion i nivelit të lartë arsimor të kishte marrë parasysh statusin tim social-kulturor, statusin familjar (fakti që jam femër, motër e një vëllai invalid, në ë e tre djemve dhe gjyshe e 5 nipërve dhe mbesave, shtu këtu dhe statusin profesional, siç është figura e mësuesit, akoma më tej drejtuese, asesi nuk duhej të më diskriminonte me ndërprerje të marrëdhënieve të punës e ca më keq akoma duhej që të kishte shmangur skandalet e medias, ndaj meje, se jam punonjëse e tij, e kështu cenohen rëndë të drejtat e liritë themelore të punonjësit, preken interesat e institucionit, përdhosen dinjiteti dhe privacia si personale ashtu dhe ajo profesionale.

Akuzohem për falsifikim të dokumentave shkollorë, ndërkohë që amza dhe regjistri shkollor dëshmojnë se nxënësit janë të pa klasifikuar dhe nuk janë pajisur me deftesë. Prokuroria dhe gjykata më kanë akuzuar në grup, pa marrë në konsideratë faktin (regjistri, amza). regjistrimet e nxënësve nuk i bën mësuesi, por drejtuesi i IA referuar dispozitave dhe udhëzimeve ligjore në arsimin bazë për vitet shkollorë 2018-2019. Në kohën që është kryer regjistrimi i nxënësve për këto vite kam qenë mësuese dhe jo drejtuese. Pretendimi që ngre prokuroria dhe gjykata është se unë duhej ti kisha vënë mungesë kundrejt vlerësimit me notën 4 dhe në akuzë nuk është cilësuar nota jo kaluese 4, apo të paklasifikuar, por shkruhet se nxënësit janë vlerësuar. Ajo që unë kam insistuar është se këta nxënës janë jo kalues në lëndën time, janë të paklasifikuar, rrjedhimisht të pacertifikuar. Kësaj gjëje i

mëshoj fort, madje pretendoj nga gjykata ta cilësojë si gabim njerëzor dhe jo falsifikim intelektual. Nuk kam pasur ndonjë interes apo përfitim financiar të çdo lloji, thjesht kam zbatuar urdhrat e drejtuesit, pa pasur asnjë përfitim ekonomik, se unë në punë isha, ngarkesën mësimore e kisha të plotësuar dhe jam e vetmja mësuese që u kam vendosur 4 në lëndën time. Tani jam mëse e bindur që gjithçka paska qenë e orkestruar dhe e dirigjuar nga eprorët e mi, unë nuk kam pasur dijeni mbi manipulimet, abuzimet dhe prapaskenat e stisura në kurrizin tim. kallëzimi penal, i kryer nga I. X ishte hakmarrje për zënien e vendit të punës, ku theksoj që ajo e bëri kallëzimin pasi e shkarkuan nga detyra për shkelje të sjelljes e etikës me kolegët dhe regjistrimet e nxënësve i ka kryer vetë ajo, bashkë me kushërinë e saj ish drejtues e zv.drejtor z.E.B e jo ndaj meje apo stafit pedagogjik. Habitem se si ngjarjet morën një tjetër rrjedhë por kam bindjen që u diktuan nga ZVAP-Kavajë e DRAP Durrës, për të mbuluar abuzimet e tyre, duke ia deleguar prokurorisë së Kavajës, të cilët më pas vepruan sipas porosisë së dhënë, ndryshe s'ka si shpjegohet ky qëndrim ndaj meje.

Absurdi i gjithë kësaj është se unë asesi nuk mund ta pranoj që të kem abuzuar me detyrën dhe për më tepër të kem falsifikuar dokumente.

Faktet dhe elementët e provave materiale janë të vërtetuara grafikisht në dokumente që disponon prokuroria e Kavajës, sot ajo e Durrësit. Kërkoj nga ana juaj që të investigohet rasti në fjalë dhe të më jepet drejtësia e munguar. Të rivendoset e drejta ime morale dhe njerëzore, pasi jam diskriminuar, diskredituar e dezinformuar edhe nga mediat e top-chanel në emisionin investigativ “Fiks –Fare” me datë 20.11.2024.

Kërkoj drejtësi, paanshmëri dhe saktësi mbi atë, çka unë pretendoj, përpos gjithçkaje jam ndier e fyer, madje e indinjuar nga ky veprim i medias, ngaqë mu bë surprizë. Përjetova ankth, stres, dëm moral, psikologjik e njerëzor, pasi jam në statusin e një figure të nderuar, siç është mësuesi, dhe për më tepër jam me statusin e gjyshes, të nënës, të gruas, të motrës dhe të femrës në tërësi. Nderi, kredoja dhe krenaria më janë përdhosur, poshtëruar e përçudnuar në mënyrën më të ulët të mundshme, nga një femër e paskrupullt siç është I.X, të cilën e njohin të gjithë në komunitet.

Përfundimisht ankuesja kërkon nga Komisioneri marrjen e masave të mëposhtme:

- Rehabilitim në vendin e punës dhe rishqyrtim të çështjes penale nga ekspertë të fushës dhe të arsimit.
- Rikthimin në detyrë dhe rimbursimin e të ardhurave nga paga ime që nga momenti i pezullimit.
- Vënien në vend të dinjitetit dhe të personalitetit tim të lënduar nga DRAP Durrës dhe nga media.

II. Ndjekja e procedurës për shqyrtimin e ankesës nga Komisioneri.

Komisioneri mori në shqyrtim ankesën bazuar në kompetencën e parashikuar nga neni 32, pika 1, gërma “a”, të LMD, që i jep të drejtën për të shqyrtuar ankesat nga personat ose grupet e personave që pretendojnë se janë diskriminuar, sipas parashikimeve të këtij ligji.

LMD, rregullon zbatimin dhe respektimin e parimit të barazisë dhe mosdiskriminimit, bazuar në një listë të hapur shkaqesh, duke përcaktuar në nenin 1, të tij se: “Ky ligj rregullon zbatimin dhe respektimin e parimit të barazisë dhe mosdiskriminimit në lidhje me racën, etninë, ngjyrën, gjuhën, shtetësinë, bindjet politike, fetare ose filozofike, gjendjen ekonomike, arsimore ose shoqërore, gjininë, identitetin gjinor, orientimin seksual, karakteristikat e seksit, jetesën me HIV/AIDS, shtatzëninë, përkatësinë prindërore, përgjegjësinë prindërore, moshën, gjendjen familjare ose martesore, gjendjen civile, vendbanimin, gjendjen shëndetësore, predispozicionet gjenetike, pamjen e jashtme, aftësinë e kufizuar, përkatësinë në një grup të veçantë, ose me çdo shkak tjetër.”

Bazuar në nenin 3, pika 1, të LMD, diskriminimi përcaktohet si : “çdo dallim, përjashtim, kufizim apo preferencë, bazuar në cilindo shkak të përmendur në nenin 1 të këtij ligji, që ka si qëllim apo pasojë pengesën apo bërjen e pamundur të ushtrimit në të njëjtën mënyrë me të tjerët, të të drejtave e lirive themelore të njohura me Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë, me aktet ndërkombëtare të ratifikuara nga Republika e Shqipërisë, si dhe me ligjet në fuqi.”

Mbrojtja nga diskriminimi, sipas nenit 7, të LMD, të ndryshuar, garantohej ndaj çdo veprimi ose mosveprimi të autoriteteve publike ose personave fizikë a juridikë që marrin pjesë në jetën dhe sektorët publikë ose privatë, që krijojnë baza për mohimin e barazisë ndaj një personi ose grupi personash, ose që i ekspozon ata ndaj një trajtimi të padrejtë dhe jo të barabartë, kur ata ndodhen në rrethana të njëjta ose të ngjashme, në krahasim me persona të tjerë ose grupe personash.

Në zbatim të parashikimeve ligjore, të neneve 32 dhe 33, të LMD, të ndryshuar, Komisioneri ka shqyrtuar çështjen duke ndërmarrë hapat si më poshtë:

1. Me shkresën nr. 1339/2 prot., datë 16.10.2025, Komisioneri njoftoi dhe kërkoi informacion në lidhje me ankesën nga DRAP Durrës në cilësinë e subjektit kundër të cilit është paraqitur ankesa.
2. Me shkresën nr.1659/1 prot., datë 04.11.2025, ka kthyer përgjigje DRAP Durrës, duke parashtruar:

Znj. E.U është pezulluar nga detyra me urdhrin nr. 86, datë 07.11.2024 të DRAP Durrës, mbi bazën e procedimit gjyqësor të nisur ndaj saj. Znj.U. ka qenë e akuzuar për kryerjen e veprës penale “*Fallsifikim i dokumentave shkollore*” parashikuar nga neni 187/2 i Kodit Penal. Nga shqyrtimi i vendimeve gjyqësore dhe akteve administrative rezulton se:

Znj. U. ka depozituar më datë 02.12.2024 një kërkesë në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë Tiranë me objekt: “*Shfuqizimin e urdhrit nr.86, datë 07.11.2024, për pezullimin nga detyra*”. Në seancën gjyqësore është provuar ligjërisht se vendimi i DRAP Durrës është marrë në përputhje me procedurat përkatëse, për shkak të shkeljeve të konstatuara dhe akuzave penale ndaj saj. Deri në përfundimin e procesit gjyqësor, masat e pezullimit mbeten në fuqi dhe znj.U. nuk mund të rikthehet në detyrë në zbatim të nenit 55, të ligjit nr. 69/2012 të ndryshuar, pika 5/b.

“Titullari i institucionit arsimor përkatës, përgjegjës për arsimin parauniversitar, ul në detyrë, pezullon, shkarkon apo përfundon marrëdhëniet e punës për drejtorin e institucionit parauniversitar arsimor publik në rastet si më poshtë:

b) për drejtorin e IPAP-së pezullohet marrëdhënia e punës dhe efektet financiare deri në shpalljen e vendimit të formës së prerë ndaj tij nga gjykata kompetente në rastet kur:

i. gjykata ka vendosur masat e sigurimit personal ndaj tij ose;

ii. është në proces hetimi për kryerjen e një veprë penale sipas nenit 60/1 të këtij ligji.”

VKM nr. 23, datë 21.13.2023, në pikën 1, të saj, po ashtu sikurse neni 60, i ligjit parashikon se: *“Punonjësi arsimor, si dhe cdo punonjës tjetër i sistemit arsimor, që punon me fëmijët, nuk mund të punësohet dhe kur është i punësuar, përfundon marrëdhënien e punës në rast se është dënuar me vendim penal të formës së prerë për kryerjen e një veprë penale, që, për shkak të natyrës së veprës së kryer, diskretiton pozitën dhe figurën e punonjësit arsimor ose dëmton rëndë besimin e publikut në sistemin arsimor, pavarësisht se është rehabilituar sipas parashikimeve të Kodit Penal.”*

Në zbatim të nenit 9, të kontratës individuale të punës të lidhur më datë 22.4.2024, gjithashtu parashikohet se punëdhënësi merr masën e pezullimit ndaj punëmarrësit nëse kanë filluar hetime paraprake ndaj drejtorit të IAP.

Drejtori i DRAP, pas njoftimit zyrtar të ZVAP, merr vendimin e pezullimit të drejtorit të IAP, deri në shpalljen e vendimit të formës së prerë ndaj tij nga gjykata kompetente. Masa e pezullimit përfundon me shuarjen e shkaqeve të pezullimit ose largimit nga puna. Gjatë kohës së pezullimit punonjësit i ndërpritet marrëdhënia financiare..

Znj. U. me vendimin nr.11-2024-338 të Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Durrës është deklaruar fajtorë për kryerjen e veprës penale të *“Fallsifikimi i dokumentave shkollorë”*, të parashikuara nga neni 187/2 të K.Penal, vepër e cila dënohet me gjobë ose burgim deri në 5 vite. Gjykata ka çmuar se kjo vepër penale për shkak të objektivitetit dhe nivelit të gjerë të përhapjes së saj, ka një ndjeshmëri të theksuar shoqërore dhe në caktimin e vendimit, gjykata mban parasysh edhe marzhin e dënimit të saj. Gjykata përfundimisht ka vendosur:

- 1. Deklarimin fajtor të të pandehurës E.U për veprën penale “Fallsifikimi i dokumenteve shkollorë”, parashikuar nga neni 187/2 të Kodit Penal dhe dënimin e saj me 9 (nëntë) muaj burgim.*
- 2. Në zbatim të nenit 406 të Kodit të Procedurës Penale ulet 1/3 (një e treta) e dënimit dhe përfundimisht e pandehura E.U dënohet me 6 (gjashtë) muaj burgim.*
- 3. Në zbatim të nenit 63 të Kodit Penal urdhërohet pezullimi i dënimit me burgim, duke e detyruar të pandehurën E.U të kryejë 60 (gjashtëdhjetë) orë punë në interes publik, për një periudhë kohe prej 6 (gjashtë) muajsh. Gjatë kësaj kohe e pandehura detyrohet të mbajë kontakte me shërbimin e provës, për t’i caktuar llojin e punës që e pandehura do të kryejë, vendin e kryerjes*

së punës dhe ditët e javës kur do të kryhet puna në interes publik. Kohëzgjatja e punës me interes publik nuk i kalon 8 orë në ditë. Pas përfundimit të punës, dënimi konsiderohet i paqenë.

4. Bazuar në nenin 33/8, të LMD, ku parashikohet: *“Kur e sheh të përshtatshme, komisioneri zhvillon një seancë dëgjimore publike dhe fton palët dhe çdo person tjetër të interesuar”,* për të sqaruar të gjitha faktet dhe rrethanat e çështjes, Komisioneri me shkresën nr. 1339/7 prot., datë 27.11.2025, njoftoi palët për zhvillimin e një seance dëgjimore në datën 12.12.2025.

Seanca dëgjimore u zhvillua në datën 12.12.2025, me pjesëmarrjen e palës ankuese znj. E.U dhe DRAP Durrës, përfaqësuar nga znj.E.H, me detyrë juriste, sipas autorizimit nr.1914/1 prot., datë 12.12.2025, lëshuar nga Drejtori i DRAP Durrës.

III. Vlerësimi i fakteve dhe provave të grumbulluara nga Komisioneri gjatë procesit të shqyrtimit të çështjes.

Parimi i barazisë para ligjit dhe i mosdiskriminimit, sanksionohet nga Kushtetuta në nenin 18, si një parim i përgjithshëm që përshkon të gjitha të drejtat dhe liritë themelore të njeriut, prandaj ai duhet të gjejë shprehjen e tij në të gjithë legjislacionin shqiptar si dhe të zbatohet nga të gjithë, si nga institucionet edhe nga individët.

Gjykata Kushtetuese në disa vendime të saj ka interpretuar nenin 18 të Kushtetutës, si dhe ka theksuar se parimi i barazisë synon që të gjithë të jenë të barabartë në ligj dhe përpara ligjit, jo vetëm në të drejtat themelore të parashikuara në Kushtetutë por edhe në të drejtat e parashikuara nga ligjet e tjera në fuqi. Gjykata është shprehur se: *“Barazia në ligj dhe para ligjit nuk do të thotë që të ketë zgjidhje të njëjlojta për individë ose kategori personash që janë në kushte objektivisht të ndryshme. Barazia përpara ligjit dhe në ligj presupozon barazinë e individëve që janë në kushte të barabarta”,* si dhe *“ Vetëm në raste përjashtimore dhe për shkaqe të arsyeshme dhe objektive mund të përligjet trajtimi i ndryshëm i kategorive të caktuara që përfitojnë nga kjo e drejtë”* (shih vendimet nr.39, datë 16.10.2007, nr. 4 datë 12.02.2010, të Gjykatës Kushtetuese).

Neni 14 i Konventës Evropiane për Drejtat e Njeriut (KEDNJ), ndalon diskriminimin në gëzimin e të drejtave dhe lirive të përcaktuara në të, ndërkohë që Protokolli 12-të i KEDNJ-së, i cili është ratifikuar nga Shqipëria, ndalon diskriminimin në lidhje me “gëzimin e çdo të drejte të parashtruar nga ligji” dhe kështu ofron mbrojtje më të madhe se sa neni 14, i cili lidhet vetëm me të drejtat e garantuara nga KEDNJ-ja.

Sipas praktikës së GJEDNJ-së, neni 14, i KEDNJ-së nuk ndalon të gjitha dallimet në trajtim, por vetëm ato diferenca të bazuara në një karakteristikë personale të identifikueshme, objektive ose personale, ose "status", me të cilin personat ose grupet e personave janë të dallueshëm nga njëri-

tjetri. GJEDNJ, në mënyrë të vazhdueshme ka interpretuar se “diskriminimi” do të thotë që të trajtosh ndryshe pa një justifikim objektiv dhe të arsyeshëm, persona të cilët ndodhen në situata të ngjashme dhe diferenca në trajtim, nuk bazohet në ndonjë justifikim objektiv dhe të arsyeshëm, domethënë, se trajtimi i diferencuar nuk ndjek një qëllim legjitim dhe nuk ekziston një marrëdhënie e arsyeshme të proporcionalitetit ndërmjet mjeteve të përdorura dhe qëllimit që synohet të realizohet. Sipas GJEDNJ, e drejta për të mos u diskriminuar e garantuar nga KEDNJ, gjithashtu çënohet kur pa një justifikim objektiv dhe të arsyeshëm shtetet dështojnë që të trajtojnë ndryshe personat situata e të cilëve objektivisht e ndryshme.

Në bazë të nenit 3, pika 1 të LMD, diskriminimi përkufizohet si: çdo dallim, përjashtim, kufizim apo preferencë, bazuar në cilindo shkak të mbrojtur në nenin 1 të këtij ligji, që ka si qëllim apo pasojë pengesën apo bërjen e pamundur të ushtrimit në të njëjtën mënyrë me të tjerët, të të drejtave e lirive themelore të njohura me Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë, me aktet ndërkombëtare të ratifikuara nga Republika e Shqipërisë, si dhe me ligjet në fuqi.

Një nga format e diskriminimit parashikuar nga LMD, është diskriminimi i drejtpërdrejtë, i cili përkufizohet nga neni 3, pika 2, të LMD, si një situatë diskriminimi që ndodh kur një person apo grup personash trajtohen në mënyrë më pak të favorshme sesa një person tjetër, apo një grup tjetër personash në një situatë të njëjtë a të ngjashme, bazuar në cilindo shkak të mbrojtur në nenin 1 të këtij ligji.

Ndërkohë, sipas nenit 6, të LMD, trajtimi i ndryshëm është i përligjur dhe ndalimi i diskriminimit i përshkruar nga ky ligj nuk zbatohet në raste kur ka një qëllim objektivisht të justifikueshëm dhe të përligjur në bazë të Kushtetutës, të marrëveshjeve apo akteve ndërkombëtare të ratifikuara nga Republika e Shqipërisë dhe legjislacioni në fuqi.

Në thelb të diskriminimit, është trajtimi i diferencuar dhe më pak i favorshëm, i shfaqur qoftë në formën e dallimit, kufizimit, përjashtimit ose preferencës dhe që ka për bazë një nga shkaqet e mbrojtura nga ligji. Pra, jo çdo diferencë në trajtim apo trajtim më pak i favorshëm gëzon mbrojtje nga ligji. Mbrojtja nga diskriminimi sipas ligjit garantohet vetëm për ato diferenca në trajtim apo trajtime më pak të favorshme që kanë për bazë një ose më shumë se një nga shkaqet e mbrojtura. Në mungesë të një shkakut të mbrojtur, jo çdo diferencë në trajtim apo trajtim i pafavorshëm konsiderohet diskriminim sipas ligjit. Gjithashtu, jo çdo diferencë në trajtim është diskriminim, por vetëm ato që nuk kanë një justifikim objektiv dhe të arsyeshëm. Pra, nëse për diferencën në trajtim konstatohet se ka një justifikim objektiv dhe të arsyeshëm, atëherë trajtimi ndryshe është i përligjur dhe nuk është i ndaluar nga ligji.

A. Lidhur me trajtimin e padrejtë, të pabarabartë dhe të pafavorshëm të pretenduar nga pala ankuese.

Për të vlerësuar pretendimin për diskriminim për shkaqet e pretenduara nga ankuesja, në radhë të parë, Komisioneri do të vlerësojë nëse ajo i është nënshtruar një trajtimi të padrejtë dhe më pak të favorshëm, në të drejtën për punësim në lidhje me pretendimet e ngritura në ankesë.

Bazuar në provat e administruara gjatë shqyrtimit të ankesës rezultoi e provuar se, ankuesja E.U që prej datës 22.4.2024 ka mbajtur detyrën Drejtore në Shkollën “Qamil Xhani”, në Bashkinë Kavajë, institucion i arsimit parauniversitar nën juridiksionin e Zyrës Vendore të Arsimit Parauniversitar Kavajë (ZVAP Kavajë).

Me urdhrin nr.86, datë 7.11.2024 “Për pezullim nga detyra”, të Drejtorit të DRAP Durrës, është urdhëruar: “1. Pezullimin nga detyra deri në marrjen e vendimit përfundimtar nga ana e organeve ligjzbatuese të znj.E.U me detyrë drejtore në shkollën “Qamil Xhani” ZVAP Kavajë, për arsye se ndaj saj është marrë vendim penal nr.11-2024-338/52 I Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Durrës. 2. Pezullimi i marrëdhënieve të punës dhe financiare të bëhet sipas datës së këtij urdhëri.....”

Ankuesja ka paraqitur pranë Komisionerit ankesën objekt shqyrtimi kundër DRAP Durrës, duke pretenduar se pezullimi i saj nga detyra si drejtuese e IAP, është diskriminues pasi ajo nuk është një person i dënuar dhe prezumohet e pafajshme sa kohë që gjykata nuk ka marrë një vendim të formës së prerë.

Rezulton se, marrëdhënia e punës së ankuseses si drejtore e IAP/Shkolla “Qamil Xhani”, Kavajë rregullohet bazuar në Kodin e Punës dhe në legjislacionin e posaçëm që rregullon arsimin parauniversitar dhe konkretisht ligji nr. 69/2012 “Për sistemin arsimor parauniversitar në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar (në vijim ligji nr.69/2012, i ndryshuar) dhe aktet nënligjore të dala në zbatim të tij.

Neni 55 “Emërimi, ulja në detyrë, pezullimi dhe shkarkimi i drejtuesit të institucionit arsimor Parauniversitar”, i ligjit nr. 69/2012, i ndryshuar, në pikën 5, germa b, të tij parashikon:

“5. Titullari i institucionit rajonal arsimor përkatës, përgjegjës për arsimin parauniversitar, ul në detyrë, pezullon, shkarkon apo përfundon marrëdhëniet e punës për drejtorin e institucionit parauniversitar arsimor publik në rastet si më poshtë:

.....

b) për drejtorin e IPAP-së pezullohet marrëdhënia e punës dhe efektet financiare deri në shpalljen e vendimit të formës së prerë ndaj tij nga gjykata kompetente në rastet kur:

i. gjykata ka vendosur masat e sigurimit personal ndaj tij ose;

ii. është në proces hetimi për kryerjen e një vepre penale sipas nenit 60/1 të këtij ligj”

Neni 60/1, të ligjit nr.69/2012, të ndryshuar, vendos kufizime për të punuar në sistemin arsimor parauniversitar, për punonjësit arsimor, si dhe çdo punonjës tjetër të sistemit arsimor, që punon me fëmijët, në rast se:

- a) është i regjistruar në Regjistrin Kombëtar të të Dënuarve për Krime Seksuale; ose
- b) është dënuar me vendim penal të formës së prerë për kryerjen e një veprë penale, që, për shkak të natyrës së veprës së kryer, diskrediton pozitën dhe figurën e punonjësit arsimor ose dëmton rëndë besimin e publikut në sistemin arsimor, pavarësisht nëse është rehabilituar sipas parashikimeve të Kodit Penal.

Sipas gurmës “c”, të nenit 60/1, të ligjit nr.69/2012, të ndryshuar, veprat penale në kuptim të shkronjës “b” të këtij neni përcaktohen me udhëzim të ministrit përgjegjës për arsimin.

Sipas nenit 60/1, të ligjit nr.69/2012, të ndryshuar, punonjësi arsimor, si dhe çdo punonjës tjetër i sistemit arsimor, që punon me fëmijët, i cili ndodhet në kushtet e parashikuara më sipër, nuk mund të punësohet dhe, kur është i punësuar, përfundon marrëdhënien e punës.

Në bazë dhe për zbatim të dispozitës së mësipërme ligjore, Ministri i Arsimit, Sportit dhe Rinisë ka miratuar udhëzimin nr. 23, datë 21.11.2023 *“Për përcaktimin e veprave penale që përbëjnë ndalim për të punuar në sistemin arsimor parauniversitar”*. (në vijim Udhëzimi I MASR nr.23/2023) Në kuptim të këtij udhëzimi përbën ndalim për të punuar në sistemin arsimor parauniversitar dënimi me vendim gjykatë të formës së prerë, ndër të tjera për veprën penale të parashikuar nga neni 187, të ligjit nr. 7895, datë 27.1.1995, *“Kodi Penal i Republikës së Shqipërisë”*, të ndryshuar.

Neni 187 *“Falsifikimi i dokumenteve shkollore”*, parashikon:

“Falsifikimi apo përdorimi i dokumenteve shkollore të falsifikuara dënohet me gjobë ose me burgim gjer në tre vjet.

Kur falsifikimi bëhet nga personi që ka për detyrë të lëshojë dokumentin, dënohet me gjobë ose me burgim gjer në pesë vjet.”

Sa më sipër, bazuar në nenin 55, pika 5/b/ii, nenin 60/1, të ligjit nr.69/2012, të ndryshuar dhe udhëzimin e MASR nr.23/2023, drejtori i institucion të arsimit parauniversitar pezullohet nga detyra në rast se është në proces hetimi për kryerjen e veprës penale të parashikuar nga neni 187, të Kodit Penal dhe kompetencën për një vendimarrje të tillë e ka titullari i institucionit rajonal arsimor përkatës, përgjegjës për arsimin parauniversitar, pra drejtori i Drejtorisë Rajonale të Arsimit Parauniversitar përkatës, në juridiksionin e të cilit përfshihet institucioni arsimor.

Nga aktet e administruara rezulton se, me vendimin nr. 11-2024-338/52, datë 29.1.2024, të Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Durrës, ankuesja është deklaruar fajtores për veprën penale *“Falsifikimi i dokumenteve shkollore”*, parashikuar nga neni 187/2 i Kodit Penal.

Në këto kushte dhe bazuar në nenin 55, pika 5/b/ii, nenin 60/1, të ligjit nr.69/2012, të ndryshuar dhe udhëzimin e MASR nr.23/2023, Komisioneri vlerëson se, urdhri nr.86, datë 7.11.2024 i Drejtorit të DRAP Durrës, për pezullimin e ankueses nga detyra si drejtore në shkollën “Qamil Xhani”, ZVAP Kavajë, deri në marrjen e vendimit përfundimtar nga ana e organeve ligjzbatuese për arsye se ndaj saj është marrë vendim penal nr.11-2024-338/52 i Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Durrës, është i drejtë dhe i bazuar në ligj. DRAP Durrës nuk e ka pezulluar ankuesen sepse e ka konsideruar person të dënuar me vendim penal të formës së prerë, nuk e ka paragjykuar dhe nuk ka shkelur parimin e prezumimit të pafajsisë. Pezullimi nga detyra i ankueses ka ardhur si pasojë e zbatimit të parashikimeve të mësipërme ligjore që vendosin detyrimin ndaj titullarit të DRAP për të pezulluar drejtuesin e IAP, në rast se ai është në proces hetimi për veprën penale të parashikuar nga neni 187, të Kodit Penal.

Detyrimi për të patur një vendim penal gjyqësor të formës së prerë, sipas rregullimit ligjor të sanksionuar nga ligji nr.69/2012, i ndryshuar, nuk kërkohet në rastin e pezullimit të marrëdhënies së punës, pasi ky i fundit ndërmerret vetëm për faktin që drejtuesi i IAP është në proces hetimi për veprat penale të parashikuara sipas Udhëzimit të MASR nr.23/2023. Sipas ligjit nr.69/2012, të ndryshuar, punonjësi arsimor, si dhe çdo punonjës tjetër i sistemit arsimor, që punon me fëmijët, i cili e është i regjistruar në Regjistrin Kombëtar të të Dënuarve për Krime Seksuale, ose është dënuar me vendim penal të formës së prerë për kryerjen e një veprë penale të parashikuar sipas Udhëzimit të MASR nr.23/2023, (ku përfshihet edhe vepra penale “*Falsifikimi i dokumenteve shkollore*”, parashikuar nga neni 187, të Kodit Penal) pavarësisht nëse është rehabilituar sipas parashikimeve të Kodit Penal, nuk mund të punësohet dhe, kur është i punësuar, përfundon marrëdhënien e punës.

Bazuar në aktet e administruara Komisioneri vlerëson se, Drejtori i DRAP Durrës ka patur kompetencën për të nxjerrë urdhrin e pezullimit të ankueses nga detyra me nr.86, datë 7.11.2024, pasi kalimi i kompetencave në lidhje me ZVAP Kavajë, nën juridiksionin e të cilës është shkolla Qamil Xhani, ka kaluar tek DRAP Tiranë, me Urdhrin e Ministrit të Arsimit dhe Sportit nr.571, datë 18.11.2024 “*Për miratimin e strukturës dhe të organikës së Zyrtare Vendore të Arsimit Parauniversitar*”. Sa më sipër, provohet se në datën 7.11.2024, drejtori i DRAP Durrës ka patur kompetencën për të nxjerrë urdhrin e pezullimit nga detyra të ankueses, pasi kalimi i ZVAP Kavajë nga DRAP Durrës tek DRAP Tiranë ka ndodhur pas kësaj date, konkretisht më datë 18.11.2024.

Për sa më lart, përfundimisht Komisioneri vlerëson se, ankuesja E.U , nuk i është nënshtruar një trajtimi të padrejtë, të pafavorshëm dhe të pabarabartë nga ana e DRAP Durrës. Në mungesë të trajtimi të padrejtë, të pafavorshëm dhe të pabarabartë, Komisioneri arrin në përfundimin që nuk kemi të bëjmë me një sjellje diskriminuese dhe shkelje të dispozitave të ligjit nr.10221/2010 “*Për Mbrojtjen nga Diskriminimi*”, të ndryshuar nga ana e subjektit kundër të cilit është paraqitur ankesa.

PËR KËTO ARSYE :

Bazuar në nenin 32 dhe 33, të ligjit nr. 10221/2010 “*Për Mbrojtjen nga Diskriminimi*”, i ndryshuar, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi,

V E N D O S I :

1. Konstatimin e mosdiskriminimit të ankueses E.U nga ana e Drejtorisë Rajonale të Arsimit Parauniversitar Durrës.
2. Kundër këtij vendimi lejohet ankim në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë Tiranë, brenda 45 ditëve nga marrja dijeni.

KOMISIONER

Robert GAJDA

Shkaku: Çdo shkak tjetër
Fusha: Punësim
Lloji i vendimit: Mosdiskriminim